



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 20 prot.

Kamëz, më 19.02 2021

V E N D I M

Nr. 16 Datë 19.02 .2021

MBI

Propozimin e dhënies së ndihmës financiare prej 94 920 (nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë për familjen e z. Kastriot Pjeter Rajta, banues në Valias, Rr "Harku i Triumfit", Lagjia Administrative Valias, Bashkia Kamez, objekti i të cilit u dëmtua nga shpërthimi i komanduar me tritol i IKMT-së tek ndërtesat e ish minierës së Valiasit.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.02.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin Nr.14 Datë 15.02.2021, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji, Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" dhe V.K.B Kamez Nr. 60, datë 23.12.2019 "Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606, Këshilli Bashkiak Kamëz :

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së dëmshpërblimit prej 94 920 (pa T.V.SH) (nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë për familjen e z. Kastriot Pjeter Rajta, banues në Valias, Rr "Harku i Triumfit", Lagjia Administrative Valias, Bashkia Kamez, objekti i të cilit u dëmtua nga shpërthimi i komanduar me tritol i IKMT-së tek ndërtesat e ish minierës së Valiasit.
2. Shuma 94 920, pa T.V.SH, (nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

